

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB 53/25 04/04/2025**

Bazuar në nenin 12 dhe 58 “h” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 5 paragrafi 2 i Rregullores (KKV) Nr. 03/23 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione, Personave Juridikë – OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim me numër të protokollit Nr. 49/23 datë 23.02.2023, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **27 mars 2025** merr këtë:


**VENDIM**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. 99/22 I DATËS**  
**28.04.2022**

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet pika 1 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.99/22 i datës 28.04.2022 për shërbimet e varrimit në Komunën e Vushtrrisë, për ritet fetare që ofrohen nga Bashkësia Islame Dega në Vushtrri, ashtu që rritet vlera e tarifës nga dyqind euro (200.00 €) sa është aktualisht, në dyqind e shtatëdhjetë euro (270.00 €).
2. Rritja prej shtatëdhjetë (70 €) euro e vlerës së kësaj tarife, bëhet si rezultat i rëndimit të gjendjes së përgjithshme ekonomike, në kushtet e ngritjes së çmimeve dhe shtrenjtimit të kostos së jetesës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës si dhe Drejtorja e Shërbimeve Publike.
4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB 55/25 04/04/2025**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 36 paragrafi 1 të Rregullës Financiare të Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike, nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 5 paragrafi 2 i Rregullores (KKV) Nr. 49/23 për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë –OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim të datës 23.02.2023, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **27 mars 2025** merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR PËRKRAHJE FINANCIARE**

1. Me këtë vendim z. \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ i ndahen mjete financiare në shumë prej katër mijë euro (4,000.00 €), ndihmë financiare për \_\_\_\_\_
2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë, Zyra e Kryetarit të Komunës, kategoria subvencione dhe transfere, kodi i programit 16024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË - MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

Nr./Br. 14400/25  
- 1 -  
Nr. Sq./Sn. sh.  
Data/ Datum: 04.04.25



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrisë**  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB 56/25 04/04/2025**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke marr për bazë propozimin e anëtari të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë z. Faton Hyseni, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **27 mars 2025** merr këtë:

**V E N D I M**


**PËR SHFUQIZIM TË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS**

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.16/25 i datës 30.01.2025 lidhur me aprovimin e petitionit të banorëve të fshatit Reznik, lagjet Kasumi, Mustafa dhe Sylja, të parashtruar në emër të z. Xhafer Kasumi, që lidhet me kërkesën e këtyre banorëve për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës me Nr.868 në fshatin Reznik.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
3. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB 58/25 04/04/2025**

Bazuar në nenin 6, të Ligji Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025, nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **27 mars 2025** merr këtë:

**VENDIM**

**PËR SHPËRNDARJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË TEJKALUARA PËR  
BUXHETIN E VITIT 2024**

1. Me këtë vendim bëhet shpërndarja e tejkalimit të planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 në kategorinë ekomomike si në vijim:

1.1 Investime kapitale.....153,327.69 €

**Totali i mjeteve të bartura.....153,327.69 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë e tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë, tabela për shpenzimet operationale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**